



SHERBIMI SOCIAL

#PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR NËNAT ME SHUMË FËMIJË



Në Janar 2023 Qeveria Shqipëtare miratoi programin e mbështetjes për nënat e papuna me tre ose me shumë fëmijë. Në kuadër të zbatimit të këtij programi, Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim të ngushtë me MSHMS po zhvillojnë takime me gratë përfituese të programit, për të diskutuar mbi këtë politikë dhe ndarë nevojat për t'u plotësuar në të ardhmen.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajit Shkurt 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë asistuar lidhur me rekomandimet për fondin deri në 6%.

Janë zhvilluar takime në Shkodër, Lezhë, Berat dhe Korçë lidhur me punësimin e anëtarëve madhorë nga familjet me NE dhe janë monitoruar të gjitha grupet rajonale lidhur me këtë tregues.

Është realizuar kontroll në DRSSSH Gjirokastrë lidhur me zbatimin e legjislacionit të NE dhe po përgatitet projekt raporti i kontrollit.





SHERBIMI SOCIAL

#BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Gjatë muajit Shkurt Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, ka vijuar turin e takimeve me pushtetin vendor, si një hallkë shumë e rëndësishme në përmbushjen e misionit të programeve tona të mbrojtjes sociale.

Elbasani, Berati, Korça, Shkodra ishin qytetet ku u ndalëm këtë muaj në diskutimet me administratorët shoqëror për të identifikuar dhe trajtuar në kohë reale kërkesat e qytetarëve.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë “Zyber Hallulli” nënshkroi me Qendrën Multifunktionale “New Generation” një Marrëveshje 4- vjeçare bashkëpunimi në fokus të së cilës është identifikimi dhe zhvillimi i pasioneve të fëmijëve.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është një gur themeli për të ardhmen e atyre fëmijëve të cilët kanë dëshirë të aftësohen në fushat profesionale të estetikës, parukerisë, etj.

Mirënjohje për New Generation dhe modele të tilla bashkëpunimi shpresojmë të zhvillojmë edhe në të ardhmen!

